

## REFERAT

### I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE PËR LËNDËT PROFESIONALE-ARTISTIKE NË FAKULTETIN E ARTEVE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të Konkursit të shpallur me datën 13.12.2025 në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat”, si dhe në ueb-faqen e Universitetit të Tetovës, [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, thirrje të bashkëpunorëve dhe thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në Universitetin e Tetovës, për një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Artet e shfaqjes skenike (6.04.02.03 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin e Arteve, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Arteve i Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më 12.02.2026 solli vendimin me nr. 20-14/4 për formimin e Komisionit recensues në përbërje:

1. **Prof. Mr. Kushtrim Bekteshi** (kryetar i komisionit), profesor ordinar në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës.
2. **Prof. Mr. Senad Abdul** (anëtar i komisionit), profesor ordinar në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës.
3. **Prof. Dr. Metin Izeti** (anëtar i komisionit), profesor ordinar në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartëpërmendur dhe në përputhje me nenin 171 dhe 172 të Ligjit për Arsim të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021 dhe 58/2024), nenit 251 të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, thirrje të bashkëpunorëve dhe thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

## RAPORT

Në konkursin e datës 13.12.2025, të shpallur në gazetata ditore „Koha” dhe „Sloboden Peçat”, si dhe në ueb-faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, thirrje të bashkëpunorëve dhe thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në Universitetin e Tetovës, për **një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Artet e shfaqjes skenike (6.04.02.03 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të**

**Fraskatit) në Fakultetin e Arteve,** në afatin e caktuar është paraqitur vetëm një kandidat: Prof. Inord. Mr. Sabedin Selmani.

Kandidati në fjalë bashkë me fletëaplikimin ka dorëzuar edhe:

- Vendimin për thirrjen mësimore-shkencore Profesor Inordinar - vendimi nr. 20-33/5 i datës 12.02.2021, sjellur nga Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës.

- Diplomën për kryerjen e studimeve të magjistraturës dhe marrjen e titullit shkencor Magjistër i Arteve (Master of Arts).

- Diplomën për kryerjen e studimeve deridiplomike.
- Biografinë me listën e aktiviteteve profesionale artistike.
- Vërtetimin / Certifikatën për njohjen e një gjuhe të huaj.
- Certifikatën nga libri amë i të lindurve.
- Certifikatën e shtetësisë.
- Punimin e magjistraturës.
- Dëshmi të mirënjohjeve dhe certifikatave.

### **Të dhënat biografike të kandidatit**

Sabedin Selmani është i lindur në Tetovë, më 17.08.1976. Në Tetovë e ka mbaruar shkollimin fillor dhe gjimnazin, ndërsa studimet në drejtimin e AKTRIMIT i ka mbaruar në vitin 2003 në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup - Fakulteti i Arteve Dramatike. Pas përfundimit të studimeve ka zhvilluar një veprimtari dinamike me aktivitete të ngjeshura si në fushën e angazhimit profesional në aktrimin teatror dhe filmik ashtu edhe në veprimtarinë kulturore në sferën e afirmimit të kulturtës skenike dhe në popullarizimin e teatrit përmes transmetimit të njohurive bashkëkohore të kësaj veprimtarie shpirtërore në brezin e rinisë studentore. Në këtë drejtim Sabedin Selmani ka shfaqur prirje dhe ka arritur suksese të dukshme në punët organizative dhe në transmetimin profesional të njohurive nga filmi, skena dhe teatri.

Kandidati Mr. Sabedin Selmani ka magjistruar në vitin 2013 në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” - Fakulteti i Arteve Dramatike, me notë mesatare 9.20, në studimet teatrore (artet performuese-skenike) – moduli AKTRIM, me Punimin e Magjistraturës: "Ndërtimi i personazhit Roberto Zuko në Teatër dhe Film", ku mori titullin Magjistër i Arteve (Master of Arts-MA) - drejtimi Aktrim.

Mr. Sabedin Selmani paraqet një profil të konsoliduar në ndërthurjen e praktikës artistike, menaxhimit kulturor dhe angazhimit institucional në arsimin e lartë, duke e pozicionuar atë si një figurë relevante në fushën e artit dramatik dhe produksionit kulturor bashkëkohor.

Në planin institucional, ai ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Komisionit për nostrifikimin e diplomave në Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2025–2026), duke dëshmuar besim dhe përgjegjësi profesionale në nivel shtetëror.

Komisioni RECENSUES ka përcjellur procesin e zhvillimit profesional dhe krijimtarinë e Mr. Sabedin Selmanit dhe është unik në vlerësimin se kandidati ka dëshmuar cilësi dhe vlera të larta:

1. në veprimtarinë mësimore-arsimore,
2. në veprimtarinë profesionale-artistike,
3. në veprimtarinë profesionale-aplikative, dhe
4. në veprimtarinë me interes më të gjërë.

## 1. VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE

Mr. Sabedin Selmani, krahas veprave autoriale, gjatë tërë kohës ka qenë i lidhur me procesin e mësimdhënies dhe të ligjërimit në Universitetin e Tetovës. Ai nga fillimi i vitit akademik 2010 është angazhuar në cilësinë e Asistentit si pedagog në programin studimor të Artit Dramatik në Fakultetin e Arteve të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Gjatë kësaj periudhe në punë është dëshmuar i përgjegjshëm, korrekt dhe i aftë për të transmetuar njohuritë përkatëse tek studentët. Nga 09.07.2010 është angazhuar si Shef i Programit studimor të Artit Dramatik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës, ku ka treguar një angazhim të madh për organizimin e programit studimor Art Dramatik gjatë realizimit të Akreditimit të ri në vitin 2013.

Në vitin 2014 me vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës (vendimi nr.02-1282/1 i datës 14.04.2014) kandidati Mr. Sabedin Selmani zgjidhet mësimdhënës në thirrjen mësimore-shkencore DOCENT, dhe nga viti akademik 2014/2015 e deri në vitin akademik 2019/2020 ka ligjëruar në lëndën Aktrim/Mjeshtri Aktori-Aktrim Intermedial në Fakultetin e Arteve - Artt Dramatik në Universitetin e Tetovës. Në muajin shkurt të vitit 2021, me vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës (vendimi nr. 20-33/5, datë 12.02.2021), kandidati Mr. Sabedin Selmani zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore PROFESOR INORDINAR në lëmin e Aktrimit (lëndë profesionale-artistike nga fusha e aktrimit), në programin studimor të Artit Dramatike në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

**Lëndët dhe mësimdhënia në ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Tetovës:**  
*(Nga shkurti 2021 deri në dhjetor 2025 në UT, Fakulteti i Arteve – Art Dramatik)*

| Nr. rendor | Emri i aktivitetit:                                                                                 | Pikët |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
|            | Nr. i orëve x Javët x pikët                                                                         |       |
| 1          | Bazat e aktrimit 3 Art Muzikor - moduli Solo Këndim (semestri V, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2   |
| 2          | Bazat e aktrimit 3 Art Muzikor - moduli Solo Këndim (semestri V, 2021/2022) ushtrime 2 x 15 x 0.03  | 0.9   |
| 3          | Bazat e aktrimit 3 Art Dramatik - Regji Teatri (semestri V, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04      | 1.2   |
| 4          | Bazat e aktrimit 3 Art Dramatik - Regji Teatri (semestri V, 2021/2022) ushtrime 2 x 15 x 0.03       | 0.9   |

|    |                                                                                                      |     |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 5  | Film, TV dhe radio lojë 3 - drejtimi Aktrim (semestri V, 2021/22) ligjerata 2 x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 6  | Film, TV dhe radio lojë 3 - drejtimi Aktrim (semestri V, 2021/22) ushtrime 2 x 15 x 0.03             | 0.9 |
| 7  | Aktrim para kamere 1 - drejtimi regji Teatri (semestri I, 2021/22) ligjerata 2 x 15 x 0.04           | 1.2 |
| 8  | Aktrim para kamere 1 drejtimi regji Teatri (semestri I, 2021/22) ushtrime 2 x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 9  | Film, TV dhe radio lojë 5 - drejtimi Aktrim (semestri VII 2021/22) ligjerata 2 x 15 x 0.04           | 1.2 |
| 10 | Film, TV dhe radio lojë 5 - drejtimi Aktrim (semestri VII 2021/22) ushtrime 2 x 15 x 0.03            | 0.9 |
| 11 | Aktrim Filmik 1 - drejtimi Aktrim (semestri I, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04                    | 1.2 |
| 12 | Aktrim Filmik 1- drejtimi Aktrim (semestri I, 2021/2022) ushtrime 2 x 15 x 0.03                      | 0.9 |
| 13 | Film, TV dhe radio lojë 1 - drejtimi Aktrim (semestri III, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04        | 1.2 |
| 14 | Film, TV dhe radio lojë 1 - drejtimi Aktrim (semestri III, 2021/2022) ushtrime 2 x 15 x 0.03         | 0.9 |
| 15 | Bazat e aktrimit 4 Art Muzikor - moduli Solo Këndim (semestri VI, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 16 | Bazat e aktrimit 4 Art Muzikor - moduli Solo Këndim (semestri VI, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.03 | 0.9 |
| 17 | Aktrim Filmik 2 - drejtimi Aktrim (semestri II, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04                   | 1.2 |
| 18 | Aktrim Filmik 2 - drejtimi Aktrim (semestri II, 2021/2022) ushtrime 2 x 15 x 0.03                    | 0.9 |
| 19 | Aktrim para kamere 2 - drejtimi regji Teatri (semestri II, 2021/22) ligjerata 2 x 15 x 0.04          | 1.2 |
| 20 | Film, TV dhe radio lojë 2 drejtimi Aktrim (semestri IV 2021/22) ligjerata 2 x 15 x 0.04              | 1.2 |
| 21 | Film, TV dhe radio lojë 2 drejtimi Aktrim (semestri IV 2021/22) ushtrime 2 x 15 x 0.03               | 0.9 |
| 22 | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2021/22) ligjerata 2 x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 23 | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2021/22) ushtrime 2 x 15 x 0.03             | 0.9 |
| 24 | Bazat e aktrimit 4 Art Dramatik - Regji Teatri (semestri VI, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.04      | 1.2 |
| 25 | Bazat e aktrimit 4 Art Dramatik - Regji Teatri (semestri VI, 2021/2022) ligjerata 2 x 15 x 0.03      | 0.9 |

|    |                                                                                              |     |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 26 | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VI, 2021/22)<br>ligjerata 2 x 15 x 0.04  | 1.2 |
| 27 | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VI, 2021/22)<br>ushtrime 2 x 15 x 0.03   | 0.9 |
| 28 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (semestri V 2022/23)<br>ligjerata 2 x 15 x 0.04    | 1.2 |
| 29 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (semestri V 2022/23)<br>ushtrime 2 x 15 x 0.03     | 0.9 |
| 30 | Aktrim para kamere 3 drejtimi regji filmi (semestri III, 2022/23)<br>ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 31 | Aktrim para kamere 3 drejtimi regji Teatri (semestri III, 2022/23)<br>ushtrime 2 x 15 x 0.03 | 0.9 |
| 32 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (semestri I, 2022/23) ligjerata 2<br>x 15 x 0.04             | 1.2 |
| 33 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (semestri I, 2022/23) ushtime 2<br>x 15 x 0.03               | 0.9 |
| 34 | Aktrim Filmik 3 drejtimi Aktrim (semestri III 2022/23) ligjerata 2<br>x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 35 | Aktrim Filmik 3 drejtimi Aktrim (semestri III 2022/23) ushtrime<br>2 x 15 x 0.03             | 0.9 |
| 36 | Aktrim Filmik 2 drejtimi Aktrim (semestri II, 2022/23) ligjerata 2<br>x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 37 | Aktrim Filmik 2 drejtimi Aktrim (semestri II, 2022/23) ushtime 2<br>x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 38 | Aktrim para kamere 4 drejtimi regji filmi (semestri IV, 2022/23)<br>ligjerata 2 x 15 x 0.04  | 1.2 |
| 39 | Aktrim para kamere 4 drejtimi regji Teatri (semestri IV, 2022/23)<br>ushtrime 2 x 15 x 0.03  | 0.9 |
| 40 | Aktrim Filmik 4 drejtimi Aktrim (semestri IV 2022/23) ligjerata 2<br>x 15 x 0.04             | 1.2 |
| 41 | Aktrim Filmik 4 drejtimi Aktrim (semestri IV 2022/23) ushtrime<br>2 x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 42 | Film, TV dhe radio lojë 4 drejtimi Aktrim (semestri VI 2022/23)<br>ligjerata 2 x 15 x 0.04   | 1.2 |
| 43 | Film, TV dhe radio lojë 4 drejtimi Aktrim (semestri VI 2022/23)<br>ushtrime 2 x 15 x 0.03    | 0.9 |
| 44 | Film, TV dhe radio lojë 4 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2022/23)<br>ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 45 | Film, TV dhe radio lojë 4 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2022/23)<br>ushtrime 2 x 15 x 0.03  | 0.9 |
| 46 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2023/24) ligjerata 2 x<br>15 x 0.04              | 1.2 |

|    |                                                                                          |     |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 47 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 48 | Radio Drama 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04               | 1.2 |
| 49 | Aktrim Filmik 3 drejtimi Aktrim (semestri III 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04           | 1.2 |
| 50 | Aktrim Filmik 3 (semestri III 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03)                           | 0.9 |
| 51 | Film, TV dhe radio lojë 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2023/24) ligjeratae 2 x 15 x 0.04  | 1.2 |
| 52 | Film, TV dhe radio lojë 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03    | 0.9 |
| 53 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (semestri VII 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 54 | Film, TV dhe radio lojë 5 (semestri VII 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03                  | 0.9 |
| 55 | Aktrim Filmik 5 drejtimi Aktrim (semestri V 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04             | 1.2 |
| 56 | Aktrim Filmik 5 drejtimi Aktrim (semestri V 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 57 | Film, TV dhe radio lojë 7 drejtimi Aktrim (semestri VII 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 58 | Film, TV dhe radio lojë 7 (semestri VII 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03                  | 0.9 |
| 59 | Aktrim Filmik 2 drejtimi Aktrim (semestri II 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 60 | Aktrim Filmik 2 drejtimi Aktrim (semestri II 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03             | 0.9 |
| 61 | Radio Drama 2 drejtimi Aktrim (semestri II 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04              | 1.2 |
| 62 | Aktrim Filmik 4 drejtimi Aktrim (semestri IV 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 63 | Aktrim Filmik 4 (semestri IV 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03                             | 0.9 |
| 64 | Film, TV dhe radio lojë 2 drejtimi Aktrim (semestri IV 2023/24) ligjeratae 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 65 | Film, TV dhe radio lojë 2 drejtimi Aktrim (semestri IV 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03   | 0.9 |
| 66 | Aktrim Filmik 6 drejtimi Aktrim (semestri VI, 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04           | 1.2 |
| 67 | Aktrim Filmik 6 drejtimi Aktrim (semestri VI, 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03            | 0.9 |

|    |                                                                                           |     |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 68 | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2023/24) ligjerata 2 x 15 x 0.04 | 1.2 |
| 69 | Film, TV dhe radio lojë 6 (semestri VIII 2023/24) ushtrime 2 x 15 x 0.03                  | 0.9 |
| 70 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04              | 1.2 |
| 71 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (semestri I 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03               | 0.9 |
| 72 | Aktrim Filmik 3 drejtimi Aktrim (semestri III 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04            | 1.2 |
| 73 | Aktrim Filmik 3 drejtimi Aktrim (semestri III 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03             | 0.9 |
| 74 | Film, TV dhe radio lojë 3 drejtimi Aktrim (semestri V 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04    | 1.2 |
| 75 | Film, TV dhe radio lojë 3 drejtimi Aktrim (semestri V 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03     | 0.9 |
| 76 | Aktrim Filmik 5 drejtimi Aktrim (semestri V 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04              | 1.2 |
| 77 | Aktrim Filmik 5 drejtimi Aktrim (semestri V 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03               | 0.9 |
| 78 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (semestri VII 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04  | 1.2 |
| 79 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (semestri VII 2024/25) ) ushtrime 2 x 15 x 0.03 | 0.9 |
| 80 | Aktrim Filmik 7 Semestri drejtimi Aktrim (semestri VII 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04   | 1.2 |
| 81 | Aktrim Filmik 7 Semestri drejtimi Aktrim (semestri VIII 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03   | 0.9 |
| 82 | Aktrim Filmik 2 drejtimi Aktrim (semestri II 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04             | 1.2 |
| 83 | Aktrim Filmik 2 drejtimi Aktrim (semestri II 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 84 | Aktrim Filmik 4 drejtimi Aktrim (semestri IV 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04             | 1.2 |
| 85 | Aktrim Filmik 4 drejtimi Aktrim (semestri IV 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03              | 0.9 |
| 86 | Film, TV dhe radio lojë 4 drejtimi Aktrim (semestri VI 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04   | 1.2 |
| 87 | Film, TV dhe radio lojë 4 drejtimi Aktrim (semestri VI 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03    | 0.9 |
| 88 | Aktrim Filmik 6 drejtimi Aktrim (semestri VI 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04             | 1.2 |

|     |                                                                                                                   |     |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 89  | Aktrim Filmik 6 drejtimi Aktrim (semestri VI 2024/25) ushtrime 2 x 15 x 0.03                                      | 0.9 |
| 90  | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04                         | 1.2 |
| 91  | Film, TV dhe radio lojë 6 drejtimi Aktrim (semestri VIII 2024/25) ) ushtrime 2 x 15 x 0.03                        | 0.9 |
| 92  | Aktrim Filmik 8 Semestri drejtimi Aktrim (semestri VIII 2024/25) ligjerata 2 x 15 x 0.04                          | 1.2 |
| 93  | Aktrim Filmik 8 Semestri drejtimi Aktrim (semestri VIII 2024/25) (semestri VIII 2024/25) ) ushtrime 2 x 15 x 0.03 | 0.9 |
| 94  | Aktrim Filmik 1b (Art Dramatik - drejtimi Regji Filmi, semestri V, 2025/26) ligjerata 1 x 15 x 0.04               | 0.6 |
| 95  | Aktrim Filmik 1b (Art Dramatik - drejtimi Regji Filmi semestri V,2025/26), ushtrime 2 x 15 x 0.03                 | 0.9 |
| 96  | Aktrim Filmik 7 drejtimi Aktrim ( Semestri VII, 2025/26) ligjerata 2 x 15 x 0.04                                  | 1.2 |
| 97  | Aktrim Filmik 7 drejtimi Aktrim ( Semestri VII, 2025/26) ushtrime 2 x 15 x 0.03                                   | 1.2 |
| 98  | Aktrim Filmik 5 drejtimi Aktrim ( Semestri V, 2025/26) ligjerata 2 x 15 x 0.04                                    | 1.2 |
| 99  | Aktrim Filmik 5 drejtimi Aktrim ( Semestri V, 2025/26) ushtrime 2 x 15 x 0.03                                     | 0.9 |
| 100 | Aktrim Filmik drejtimi Aktrim (Semestri III, 2025/26) ligjerata 2 x 15 x 0.04                                     | 1.2 |
| 101 | Aktrim Filmik 3 drejtimi Aktrim (Semestri III, 2025/26) ushtrime 2 x 15 x 0.03                                    | 0.9 |
| 102 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (Semestri I, 2025/26) ligjerata 2 x 15 x 0.04                                     | 1.2 |
| 103 | Aktrim Filmik 1 drejtimi Aktrim (Semestri I, 2025/26) ushtrime 2 x 15 x 0.03                                      | 0.9 |
| 104 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (Semestri VII, 2025/26) ligjerata 2 x 15 x 0.03                         | 1.2 |
| 105 | Film, TV dhe radio lojë 5 drejtimi Aktrim (Semestri VII, 2025/26) ushtrime 2 x 15 x 0.03                          | 0.9 |

Nga informatat që ka pasur në dispozicion ky komision, ka konstatuar se kandidati është i socializuar, i hapur, komunikativ dhe i aftë për transmetimin e njohurive edukative – mësimore profesionale në nivel akademik.

## 2. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – ARTISTIKE

Në fushën e vokacionit të tij profesional Mr. Sabedin Selmani ka arritur suksese si në angazhimin në role në teatër ashtu edhe në film. Në teatër gjer më tani ka luajtur afro 30 role prej të cilave shumicën kryesore dhe të tjerat role të rëndësishme. Nga kritika tetatrore është vlerësuar si njëri ndër aktorët më të sukseshëm dhe më premtues i brezit të tij. Kandidati është dëshmuar edhe në fushën e artit kinematografik në të cilin ka realizuar 4 filma si dhe ka themeluar festivalin ndërkombëtar të filmit “ TIFF ODA Tetova International Film Festival”.

Veprimtaria artistike e Mr. Sabedin Selmanit përfaqëson një profil të artikuluar krijues, të ndërtuar mbi ndërthurjen organike të regjisorës, dramaturgjisë, interpretimit dhe menaxhimit kulturor. Përvoja e tij si drejtues produksioni në **ODA**, si dhe angazhimi udhëheqës në **TIFF ODA Tetova International Film Festival**, i kanë dhënë veprimtarisë së tij një dimension të gjerë estetik dhe institucional, duke e pozicionuar atë si një ndër figurat aktive në konsolidimin e skenës teatrore dhe filmike bashkëkohore në kontekstin vendor dhe rajonal.

Producent dhe aktor në filmin “Remember”, prodhim i produksionit “ODA”-Tetovë, nëntor 2025; Autor, regjisor dhe producent i shfaqjes teatrore “Ballkanibalizem 2” - prodhim i produksionit “ODA”- Tetovë, nëntor 2024; Regjisor dhe autor i shfaqjes teatrore “Çanta e nje gruaje”, prodhim i produksionit “ODA”- Tetovë, korik 2023; Regjisor dhe autor i shfaqjes teatrore “Magic show 2”, prodhim i produksionit “ODA”- Tetovë, qershor 2022; Regjisor, producent dhe aktor në filmin “Tetë ditët e javës”, prodhim i produksionit “ODA”- Tetovë, nëntor 2023; Regjisor, autor dhe producent i shfaqjes teatrore “Pankdemia”, prodhim i produksionit “ODA”- Tetovë, nëntor 2021; Ko-regjisor i shfaqjes teatrore për fëmijë “Vëllau pate” nga Darko Kovacevski, produksion i “ODA”- Tetovë, korrik 2021.

Nga të dhënat biografike dhe veprat autoriale të theksuara më lartë, Komisioni recensues ka konstatuar se Mr. Sabedin Selmani është zhvilluar fuqishëm si krijues, veprat e të cilit kanë lënë gjurmë në kulturën e përgjithshme. Mr. Sabedin Selmani në veprimtarinë e tij krijuese ka kultivuar teatrin dhe filmin duke u shquar me imagjinatë të bujshme dhe invencion në plasimin e ideve, kuptimeve përkatësisht shumëkuptimësisë në përcjelljen e mesazheve dhe të koncepteve origjinale mbi rrjedhat e zhvillimeve të mundshme aktuale.

## 3. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE

Si rrjedhojë e sukseseve të lakmueshme në shfaqjet më të suksesshme të Teatrit Shqiptar të Shkupit ka marrë pjesë në 30 festivale prestigjioze me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga materiali në dispozicion të komisionit shihet se kandidati Mr. Sabedin Selmani është i angazhuar në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare si aktor, regjisor dhe producent. Si aktor tejet inventiv, i cili me rolet e realizuara ka ndikuar për arritjen e suksesit të shfaqjeve, ka marrë pjesë në shfaqjet e organizuara nga Teatri Shqiptar i Shkupit në: Riga (Lituanë), 1999; Stokholm (Suedi), 1999; në Bienale Bon (Gjermani), 2000; në Skampa (Elbasan), 2003; në Prilep, Dibër dhe Fier 2004; Budva 2003; Ohër 2003; Sain Denis (Paris) 2005; Saint Petersburg dhe Moskë 2005; Beograd 2010; Shqipëri 2012; etj.

Veprat autoriale të Mr. Sabedin Selmanit, shfaqjet dhe filmat e tij gjatë periudhës 2021–2026 janë prezantuar në festivale dhe manifestime të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Filmat e tij me metrazh të shkurtër “Rregulla Arti” dhe “Tetë ditët e javës”, në cilësinë e skenaristit dhe regjisorit, janë për zgjedhur në festivale si Festivali Ndërkombëtar i Filmit DROPUL, Zlatna Ramka, Drim Short Film Festival dhe TIFF ODA Tetova International Film Festival. Filmi “Remember”, në të cilin ka kontribuar si producent, është prezantuar po ashtu në TIFF ODA (2025). Në fushën teatrale, shfaqjet “Ballkanibalizëm” dhe “Pankdemia”, në regjinë e tij, kanë qenë pjesë e manifestimit “Vera Kulturore” në Tetovë, ndërsa “Ballkanibalizëm 2” është realizuar edhe si turne në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë së Veriut. Aktiviteti “Open Air Cinema”, si projekt autorial i tij dhe producent, është zhvilluar në kuadër të të njëjtit manifestim përgjatë disa viteve radhazi:

*Me filmin artistik me metrazh të shkurtër “Rregulla Arti” (skenarist dhe regjisor) :*

2024 – Festivali Ndërkombëtar i Filmit “DROPUL” (Shqiperi), gusht 2024.

2021 – “TIFF ODA” Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Tetovë, Maqedonia e Veriut (“TIFF ODA” Tetovo International Film Festival).

*Me filmin artistik me metrazh të shkurtër “Tetë ditët e javës” (skenarist dhe regjisor):*

2024 – Festivali “Zlatna Ramka”, Maqedonia e Veriut.

2024 – Festivali “Drim short film festival”, Maqedonia e Veriut.

2023 – “TIFF ODA” Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Tetovë, Maqedonia e Veriut (“TIFF ODA” Tetovo International Film Festival).

*Me filmin artistik me metrazh të shkurtër “REMEBER” (Producent):*

2025 – “TIFF ODA” Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Tetovë, Maqedonia e Veriut (“TIFF ODA” Tetovo International Film Festival).

*Me shfaqjen teatrale “Ballkanibalizem” (regjisor):*

2024 - Turne në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë së Veriut, me shfaqjen “Ballkovidizëm 2”.

2023/22 - Pjesëmarrje në “Vera kulturore” me shfaqjen “Ballkanibalizëm1”, Tetovë

2021- Pjesëmarrje në “Vera kulturore” me shfaqjen “Ballkanibalizëm 2”, Tetovë

*Me shfaqjen teatrale “Pankdemia” (regjisor):*

2025/24 - Pjesëmarrje në “Vera kulturore”, Tetovë

*Me aktivitetin “Open air cinema” (autor dhe producent):*

2025/24/23/22 - Pjesëmarrje në “Vera kulturore”, Tetovë

#### **4. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË**

Mr. Sabedin Selmani, paraqet një profil të konsoliduar në ndërthurjen e praktikës artistike, menaxhimit kulturor dhe angazhimit institucional në arsimin e lartë, duke e pozicionuar atë si një figurë relevante në fushën e artit dramatik dhe produksionit kulturor bashkëkohor. Në cilësinë e Drejtorit të Produksionit në ODA, ai ka luajtur rol kyç në strukturimin organizativ dhe konceptual të projekteve teatrale dhe filmike, duke kontribuar në profesionalizimin e praktikave të menaxhimit kulturor. Angazhimi i tij si Kryetar, Selektor dhe Organizator i TIFF ODA Tetova International Film Festival dëshmon për kompetencë kuratoriale dhe vizion strategjik në ndërtimin e një platforme që promovon dialog ndërkulturor dhe bashkëpunim artistik në nivel ndërkombëtar. Në planin krijues, Mr. Sabedin Selmani është shquar si regjisor, autor dhe

producent i një sërë veprash teatrore dhe filmike, të cilat karakterizohen nga një qasje kritike ndaj fenomeneve shoqërore dhe një artikulum i qartë estetik. Veprat si “Pankdemia”, “Magic Show”, “Çanta e një gruaje”, “Ballkanibalizëm 2” dhe filmi “Tetë ditët e javës” reflektojnë një vazhdimësi tematike dhe konceptuale, ku dramaturgjia ndërtohet mbi analiza sociale dhe struktura performative bashkëkohore. Angazhimi i tij si producent dhe aktor në filmin “Remember” dëshmon për shtrirjen e tij të plotë në procesin krijues dhe për aftësinë për të operuar në nivele të ndryshme të prodhimit artistik.

Në dimensionin akademik, kontributi i tij në kuadër të **Universiteti i Tetovës**, respektivisht në **Fakulteti i Arteve**, ka qenë i orientuar drejt zhvillimit të programeve studimore dhe garantimit të standardeve profesionale në proceset përzgjedhëse. Pjesëmarrja në komisione për hartimin e elaborateve të programit Art Dramatik, në komisione të provimeve pranuese dhe në procese verifikimi institucional dëshmon për integritet akademik dhe përkushtim ndaj avancimit të cilësisë në arsimin artistik. Në tërësi, Mr. Sabedin Selmani paraqet një model të integruar të artistit dhe menaxherit kulturor, i cili e koncepton praktikën krijuese si proces estetik, refleksiv dhe institucional njëkohësisht. Veprimtaria e tij kontribuon në konsolidimin e diskursit teatral dhe filmik bashkëkohor, si dhe në forcimin e infrastrukturës kulturore dhe akademike në kontekstin vendor dhe rajonal.

2021-2026 – Drejtor i produksionit “ODA”, Tetovë.

2021-2026 – Kryetar i Festivalit të Filmit Ndërkombëtar “TIFF ODA Tetova International Film Festival.

2021-2026 – Selektor në “TIFF ODA” Tetovo International Film Festival.

2021-2026 – Organizator në “TIFF ODA” Tetovo International Film Festival.

2021-2026 – Organizator i projektit “Mobi kino – Kinemaja shëtitëse”.

2021-2026 – Organizator i projektit “ODA FEST”.

Në planin institucional, ai ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Komisionit për nostrifikimin e diplomave në Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2025–2026), duke dëshmuar besim dhe përgjegjësi profesionale në nivel shtetëror.

### **Aktivitetet dhe angazhimi akademik në Universitetin e Tetovës:**

- Anëtar i bordit të Fakultetit të Arteve për bashkëpunim dhe besim me publikun.
- Anëtar i Komisionit për përgatitjen e Elaborateve të programeve studimore të ciklit të parë të programit studimor Art Dramatik, 2025.
- Anëtar i komisionit për mbajtjen e provimit pranues në programin studimor Art Dramatik të Fakultetit të Arteve në konkurset e viteve akademike 2022/2023, 2024/2025, 2025/2026.
- Pjesëmarrës në Ditët e hapura të UT-së - prezantimi i programeve studimore të Universitetit të Tetovës para maturantëve.

Me qëllim që Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës si dhe instancat më të larta vendimmarrëse ta kenë një pasqyrë më të detajuar mbi veprimtarinë e përgjithshme të kandidatit Mr. Sabedin Selmani, Komisioni recensues e shih të arsyeshme që ta sjellë pasqyrën e veprave autoriale, angazhimeve profesionale dhe pedagogjike, si dhe vlerësimin

e tyre në hapësirën kombëtare e ndërkombëtare, nga data e vendimit të zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore Profesor Inordinar e deri në datën e shpalljes së këtij konkursi, respektivisht nga data 12.02.2021 deri në 13.12.2025.

Më poshtë, në pjesën e SHTOJCËS së raportit, po e japim edhe pasqyrën mbi vlerësimin dhe numrin e pikëve për valorizimin e veprave me të cilat fitohen thirrjet universitare.

Komisioni Recensues është unik në vlerësimin se bazuar në veprat autoriale dhe përvojën profesionale dhe pedagogjike, kandidati Mr. Sabedin Selmani ka arritur shkallë të gjërë të njohurive dhe të ngritjes profesionale dhe njeh, përveç shqipes standarde si gjuhë amëtare, edhe gjuhën maqedonase dhe angleze në nivel të lartë.

Siç mund të shihet nga tabelat e mëposhtme në pjesën SHTOJCË të referatit, kandidati mr. Sabedin Selmani nga sfera e veprimtarisë mësimore-arsimore ka tubuar 110.4 pikë, nga sfera e veprimtarisë profesionale-artistike 57 pikë, nga sfera e veprimtarisë profesionale-aplikative 34 pikë dhe nga sfera e veprimtarisë me interes më të gjërë 12.5 pikë. Shuma totale prej 213.9 pikësh, duke pasur parasysh veprimtarinë e ngjeshur, përcakton vlerësimin maksimal të veprimtarisë së tij lidhur me kontributin në punën akademike në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës dhe veprimtarinë artistike në fushën e teatrit dhe filmit në hapsirat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga të gjitha konstatimet, vlerësimet dhe gjykimet që ka nxjerrë në bazë të veprës autoriale dhe përvojës profesionale-pedagogjike për kandidatin Mr. Sabedin Selmani, Komisioni recensues në unison të plotë, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës, Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, përmes tij Senatit të Universitetit të Tetovës, ia paraqet këtë:

## **PËRFUNDIM DHE PROPOZIM**

